

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

---

Nr.2500regj.Them

Data rregj.07.05.2019

Data vendimit 02.07.2019

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTARE-VJOLLCA SPAHIU

Asistuar prej sekretares gjyqësore znj.Elenita Myftari, Tiranë, sot më datë 02.07.2019 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr.2500Akti, me palë:

**KËRKUES:** E.. T., e identifikuar me pasaporte biometrike nr... dhe numer J .. .., e bija e G.. dhe E., e dtl.27.01.19., lindur dhe banuese Tirane, Rr...., banesa nr..., me shtetësi dhe kombesi shqiptare, beqare, e pa denuar me pare, arsimi i mesëm per kanto, perfaqësuar me deklarim dhe prokure nga av.Saimir Visha me nr.677license dhe nipt K 31512073 C antar i dhomes se avokatise Tirane.

2.E..N., i identifikuar me pasaporte biometrike BF .. dhe numer personale J .., i biri i A.. dhe Sh., i dtl.07.10.19..., arsimi i mesem, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, lindur në Laç dhe banues Fushe Milot, perball zyrave në ..., beqar, perfaqësuar me deklarim dhe prokure nga av.Saimir Visha me nr.677license dhe nipt K 31512073 C antar i dhomes se avokatise Tirane.

**PERSON I TRETË:** Prokuroria e Rrethit Gjyqsor Tiranë përfaqësuar nga prokurori Zeqir Hoda.

**OBJEKTI:** Kërkohet heqja e sekuestros të vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësor z.Alban XHEDIKU, sipas procesverbalit të datës 14.04.2019, ora 18:10 dhe urdhërimi i kthimit të dokumenteve dhe i shumës së sekuestruar prej 13.000 (trembëdhjetë mijë) Euro tek shtetasja E.G. T.. Kërkohet heqja e sekuestros të vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësor z.Alban XHEDIKU, sipas procesverbalit të datës 14.04.2019, ora 17:30

dhe urdhërimi i kthimit të dokumenteve dhe i shumës së sekuestruar prej 14.000 (katërbëdhjetë mijë) Euro tek shtetasi E.A.N...

BAZA LIGJORE : Nenet 1, 2, 4, 6, 8/a, 10, 34/a, 48, 50, 110, 208, 300 dhe 301 të Kodit të Procedurës Penale. Nenet 250 e vijues të Kodit Doganor të RSH.

Nenet 5, 17, 30, 42, 43, 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe nenin 2 i Protokollit shtesë Nr.7 të kësaj konvente.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuarit dhe provat bashkëlidhur saj, si dhe dëgjoi pretendimet e palëve në lidhje me çështjen në gjykim,

#### V Ë R E N

Rrethanat e çështjes.

Kërkuarit E..T..dhe E.. N., ka paraqitur pranë kësaj Gjykate, kërkesën penale me objekt heqja e sekuestros të vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësor z.Alban XHEDIKU, sipas procesverbalit të datës 14.04.2019, ora 18:10 dhe urdhërimi i kthimit të dokumenteve dhe i shumës së sekuestruar prej 13.000 (trembëdhjetë mijë) Euro tek shtetasja E. G. T... Kërkohej heqja e sekuestros të vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësor z.Alban XHEDIKU, sipas procesverbalit të datës 14.04.2019, ora 17:30 dhe urdhërimi i kthimit të dokumenteve dhe i shumës së sekuestruar prej 14.000 (katërbëdhjetë mijë) Euro tek shtetasi E.. A.N..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i kërkesës rezultoi se,

Me datë 14.04.2019, shtetasit kërkuar kanë qenë duke udhëtuar drejt Barcelonës, Spanjë me linjën "Blue Panorama" Rinas-Romë-Barcelonë.

Pas kontrollit fizik në vijën e dytë, shtetasit E. G. T. i janë gjetur 13.000 (trembëdhjetë mijë) Euro dhe shtetasit E.. A. N. i janë gjetur 14.000 (katërbëdhjetë mijë) Euro, shuma të cilat këto shtetas nuk i kishin deklaruar në doganë. Në vijim, nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësor, pranë Komisarariatit të Policisë Rinas, z.Alban Xhediku bazuar në Nenin 300/2 është vendosur sekuestrimin i dokumenteve dhe i shumave të valutave në fjalë. Në gjykimin tonë, si mbrojtës së kërkuarve, vendosja e sekuestros së shumave në fjalë është bërë në kundërshtim me provat, faktet dhe ligjin. Prandaj, në kushtet kur nga ana e Prokurorisë nuk ishte bërë ende vlerësimi i sekuestros në fjalë edhe pse ka kaluar afati i parashikuar në nenin 301 të K.Pr.Penale, i kemi kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

nëpërmjet kërkesës së datës 20.04.2019, të dërguar znj.Elisabeta Imeraj, Drejtuese e Prokurorisë, kërkesë kjo e dërguar nëpërmjet shërbimit postar me Postë Rekomande me Dëftesë Pranimi Nr. 1019, datë 20.04.2019, që të bënte vlerësimin si të paligjshëm të vendimit për sekuestrimin e dokumenteve dhe shumave monetare, si dhe të urdhëronte e kthimin e tyre tek shtetasit kërkuar.

Nga data 20.04.2019 i pajisur me prokurën e posaçmë një kopje të të cilave ia kam vënë në dispozicion prokurorisë, nuk kemi marrë asnjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë edhe pse ka kaluar çdo afat ligjor i parashikuar si nga neni 301 ashtu edhe nga neni 110 i K.Pr.P, duke mos pasur një përgjigje në tejkallim të afateve, si dhe në zbatim të së drejtës së parashikuar në nenin 301 të K.Pr.P. i drejtohem gjykatës që të vendos për heqjen e sekuestros dhe të urdhërojë kthimin e dokumenteve dhe vlerave monetare të sekuestruara në mënyrë të paligjshme nga OPGJ.

Në rastin konkret, mosdeklarimi ka ardhur si pasojë e mospasjes dijeni nga ana e këtyre shtetasve për detyrimin për deklarimin e tyre. Nga ana tjetër, mosdeklarimi i të hollave në masën e sekuestruar nuk përbën asnjë element të ndonjë veprë penale sipas Kodit Doganor dhe rrjedhimisht edhe Kodit Penal. Prandaj, si rrjedhojë këto mjete monetare dhe dokumentet në fjalë nuk mund të ishin dhe nuk mund të jenë objekt i sekuestrimit sipas Kodit të Procedurës Penale të RSH.

Referuar neni 301 të Kodit të Procedurës Penale, OPGJ duhet t'i njoftonte procesverbalin e sekuestrimit prokurorit brenda 48 orëve dhe ndërkohë, ky i fundit duhet të bënte vlerësimin e sekuestros brenda 48 orëve. Në këto kushte, është e qartë që sot me datë 20.04.2019, ora 10:00 që bëhet kërkesa, afati ligjor për të vlerësuar këtë sekuestro ka kaluar dhe për pasojë ajo ka humbur fuqinë ligjore.

Vendimi i prokurorit për vlerësimin e sekuestros sipas neni 301 të K.Pr.Penale duhet t'i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë pasi e ka vlerësuar atë brenda 48 orëve. Në rastin, konkret, nuk ekziston një vendim i tillë edhe pse mbrojtja e kërkuarve i ka kërkuar prokurorisë të disponojë sipas ligjit. Ky vendim as nuk ekziston dhe as nuk na është njoftuar sipas ligjit.

Per sa me sipër bazuar në normat juridike të sipërcituara, në argumentet e sipërpërmendura, argumentet e tjera, kërkohet heqjen e sekuestros të vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësor z. Alban Xhediku, sipas procesverbalit të datës 14.04.2019, ora 18:10 dhe urdhërimin e kthimit të dokumenteve dhe të shumës së sekuestruar prej 13.000 (trembëdhjetë mijë) Euro tek shtetasja E.G.. T..

Heqjen e sekuestros të vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësor z.Alban Xhediku sipas procesverbalit të datës 14.04.2019, ora 17:30 dhe urdhërimin e kthimit të dokumenteve dhe të shumës së sekuestruar prej 14.000 (katërmëdhjetë mijë) Euro tek shtetasi E.A. N..

Në këtë gjykim, prokurori i senaces gjyqësore, u shpreh se nuk është dakort me kërkesën e paraqitur nga kërkuarët në lidhje me kthimin e sendet e sekuestruara, pasi çështja është në

faze hetimi dhe nuk është verifikuar akoma burimi i këtyre të ardhurave nga dy shtetas në moshe të re dhe që nuk kanë të vertetuar asnjë ditë pune.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kërkesës, se mesipërme, e cila i përket juridiksionit dhe kompetencës së kësaj gjykate, ka rezultuar se :

Neni 207

Sekuestrimi gjatë kontrollit

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

- 1.Sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit.
- 2.Sende të tjera të gjetura gjatë kontrollit, që nuk përfshihen në vendimin përkatës, por që lidhen me të njëjtën veprë penale, mund të sekuestrohen duke respektuar dispozitat për sekuestrimet.
- 3.Kur gjatë kontrollit zbulohen sende që nuk kanë lidhje me veprën penale për të cilat është dhënë vendimi i kontrollit, por që lidhen me një veprë tjetër penale që ndiqet kryesisht, sendet e zbuluara sekuestrohen.
- 4.Për sekuestrimet e kryera në kushtet e paragrafëve 2 dhe 3, të këtij neni, zbatohen kriteret e nenit 301 të këtij Kodi.

Neni 217

Kthimi i sendeve të sekuestruara

- 1.Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyera.
- 2.Gjykata mund të disponojë që kthimi i sendeve të mos bëhet kur, me kërkesën e prokurorit ose të paditësit civil, duhet të mbahet sekuestrimi për të siguruar padinë civile. 3.Pasi vendimi merr formë të prerë, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë, përveç rasteve kur vendoset konfiskimi.

Neni 218

Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara

1.Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.

2.Kur sendet janë sekuestruar pranë një të treti, kthimi nuk mund të urdhërohet në dobi të të tjerëve, pa u dëgjuar i treti nga gjykata.

3.Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë.

Sa më sipër, kërkuesit E. T. dhe E.N., kërkun pranimin e kërkesës sipas objektit të saj, ndërsa prokurori kërkoi rrëzimin e saj.

Vlerësimi i Gjykatës.

Lidhur me kthimin e sendit të sekuestruar.

Sekustrimi është një mjet kërkimi prove që ka për qëllim marrjen dhe ruajtjen nga ana e organit procedues të provave dhe të sendeve që kanë lidhje dhe i përkasin veprës penale. Në bazë të nenit 208 të K.Pr.Penale Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale, kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm.

Në vetvete sekuestroja si masë preventive e marrë gjatë procesit penal pavarësisht se cili është organi procedurës i cili disponon në vendosjen e saj në varësi të situatës ligjore dhe fazës së gjykimit kufizon të drejtën e disponimit të pasurisë të mbajtësit të pasurisë. Në këtë mënyrë për të garantuar këtë të drejtë nga veprimet abuzive të organit procedues është pranuar që pavarësisht se prokurori ka autoritetin e kryerjes së hetimit dhe sipas parimit të përgjithshëm ligjshmëria e të gjitha veprimeve do të kontrollohet në fazën e gjykimit nga gjykata, ligjvënësi ka parashikuar kontroll të posaçëm, ku sipas nenit 301/2 në rastin e sekuestros së vendosur nga policia gjyqësore në raste të ngutshme dhe vleftësuar si e ligjshme nga prokurori, subjektet e interesuara të nominuara në këtë dispozitë kanë të drejtën e kundërshtimit të saj nëpërmjet ankimit të veçantë vetëm kundër këtij veprimi procedural. Vendosja e të drejtës së ankimit ka si qëllim verifikimin e ligjshmërisë së sekuestros nëpërmjet ndërhyrjes së gjykatës mbi ankimin e subjektit të interesuar. Ligji në çdo rast parashikon detyrimin e prokurorit në njoftimin e vendimit. Por e drejta e ankimit lind vetëm në rastin kur subjektit i janë cenuar të drejtat nga vendimi i prokurorit, i cili e ka vleftësuar si të ligjshëm sekuestron pasi në rastin kur prokurori nuk e miraton sekuestron e kryer nga policia gjyqësore është vetë ai që e ndërpret gjendjen e paligjshmërisë dhe rivendos të drejtat e cenuara. Pavarësisht se ligji nuk e ka specifikuar se kjo e drejtë lind kur vendoset

sekuestroja dhe jo në rastin kur hiqet, në vazhdim të formulimit të të drejtës së ankimit dhe subjekteve që ju njihet kjo e drejtë, kuptohet që bëhet fjalë për subjektet e cenuara nga kjo masë procedurale dhe për më tepër mbasi ligjvënësi ka shpjeguar të drejtën e ankimit ka përcaktuar se ankimi nuk e pezullon zbatimin e sekuestros, ç'ka të çon në konkluzionin se bëhet fjalë për rastin kur është vendosur sekuestroja.

Në nenin 217 të K.Pr.Penale nën titullin “Kthimi i sendeve të sekuestruara” parashikohet shprehimisht se: “1. Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyer. 2. Gjykata mund të disponojë që kthimi i sendeve të mos bëhet kur, me kërkesën e prokurorit ose të paditësit civil, duhet të mbahet sekuestrimi për të siguruar padinë civile. 3. Pasi vendimi merr formë të prerë, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë, përveç rasteve kur vendoset konfiskimi.”, ndërsa në nenin 218 të këtij Kodi nën titullin “Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara” parashikohet se: “1. Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.

2. Kur sendet janë sekuestruar pranë një të treti, kthimi nuk mund të urdhërohet në dobi të të tjerëve, pa u dëgjuar i treti nga gjykata. 3. Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë.”. Po ashtu, në nenin 301 të K.Pr.Penale nën titullin “Vleftësimi i sekuestros” ku parashikohet se: “1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja. 2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t’i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon pengimin e sekuestros.”. Këto dispozita duhet të interpretohen në mënyrë sistematike me nenin 190 të K.Pr.Penale, ku thuhet se: “Disponimi për provat materiale” parashikohet se: “1. Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar: ....ç) sendet e tjera u kthehen personave që u takojnë dhe, kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata. 2. Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes.”.

Nga interpretimi logjik dhe sistematik i dispozitave të cituara më lartë rezulton se që të pranohet kthimi i sendit të sekuestruar përpara përfundimit të hetimeve duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: së pari, sendi i sekuestruar të mos mbahet për qëllim prove.

Së dyti, kërkesa për kthimin e provës materiale duhet të bëhet nga personi që është pronar i sendit të sekuestruar. Së treti, gjykata vendos kthimin e sendit të sekuestruar kur nuk ka dyshim lidhur me përkatësinë e tyre. Nëse pronësia e sendit të sekuestruar vihet në dyshim, sendi ruhet gjersa të zgjidhet nga gjykata me vendim të formës së prerë se kujt i takon pronësi. Në këtë situat jemi edhe kur sendi i sekuestruar mund të rezultoj i vjedhur pavarësisht se personi të cilit i gjendet sendi i vjedhur nuk është autori i vjedhjes dhe nuk ka dijeni për këtë fakt. Në këtë konkluzion arrin gjykata duke iu referuar nenit 166 të Kodit Civil nën titullin “Fitimi me mirëbesim i sendeve të luajtshme”, ku parashikohet shprehimisht se: “Personi që në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luajtshëm, bëhet pronar i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponues i tij. Megjithatë fituesi, qoftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit kur ky është i vjedhur. Fituesi me mirëbesim bëhet pronar i monedhave dhe i letrave me vlerë tek prurësi, edhe sikur këto t’i jenë vjedhur ose t’i kenë humbur pronarit ose personit juridik publik. Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për sendet e luajtshme që janë të shënuara në regjistrat publike.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite sendet e sekuestruara siç mund të jenë automjetet e ndryshme që janë të shënuar në regjistrat publik e që janë të vjedhura nuk kalojnë asnjëherë në pronësinë e personit që me mirëbesim mund ta ketë blerë nga një person tjetër edhe ky me mirëbesim ose keqëbesim. Në këto kushte, ky person (blerësi i fundit me mirëbesim) nuk mund të kërkoj kthimin e sendit të vjedhur apo që dyshohet i vjedhur e që është sekuestruar nga prokuroria pa u përcaktuar pronari i vërtet. Në të kundërt, Gjukata do të vepronte në kundërshtim me nenin 218 pika 1 të K.Pr.Penale, ku thuhet se: “1. Gjukata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.”.

Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjukata çmon se kërkesa e paraqitur nga shtetasit E.T.dhe E. N., duhet rrëzuar si e pabazuar në prova dhe në ligj. Kjo për këto arsye: Së pari, ligjvënësi ka parashikuar kontroll të posaçëm, ku sipas nenit 301/2 të K.Pr.Penal në rastin e sekuestros së vendosur nga policia gjyqësore në raste të ngutshme dhe vleftësuar si e ligjshme nga prokurori, subjektet e interesuara të nominuara në këtë dispozitë kanë të drejtën e kundërshtimit të saj nëpërmjet ankimit të veçantë vetëm kundër këtij veprimi procedural. Vendosja e të drejtës së ankimit ka si qëllim verifikimin e ligjshmërisë së sekuestros nëpërmjet ndërhyrjes së gjykatës mbi ankimin e subjektit të interesuar. Ligji në çdo rast parashikon detyrimin e prokurorit në njoftimin e vendimit. Por e drejta e ankimit lind vetëm në rastin kur subjektit i janë cenuar të drejtat nga vendimi i prokurorit, i cili e ka vleftësuar si të ligjshëm sekuestron pasi në rastin kur prokurori nuk e miraton sekuestron e kryer nga policia gjyqësore është vetë ai që e ndërpret gjendjen e paligjshmërisë dhe rivendos të drejtat e cenuara.

Së dyti, kërkesit nuk provojë përpara gjykatës se të hollat që janë sekuestruar në kufi jane si rezultat i nje aktiviteti te ligjshem pasi kerkuesit jane ne moshe te re dhe nuk kane qenë te punesuar. Të gjitha këto fakte krijojnë dyshime mbi përkatësinë e sendeve të sekuestruara

objekt gjykimi, prandaj nuk mund t'i kthehet kërkesve pa u hetuar nga prokuroria për të hequr çdo dyshim për përkatësinë e tyre.

Se treti sendet e sekuestruara objektet kërkesë mbahen nga prokuroria me qëllim prove, pasi sikurse e deklaroi gjatë gjykimit prokuroria ka dyshime se këto të holla janë produkt i veprës penale të “Mosdeklarimit të të ardhurave, të hollave dhe sendeve me vlerë në kufi”, parashikuar nga neni 179/a/ të Kodit Penal, të cilat nëse do të provohet i nënshtrohen konfiskimit dhe kalimit në favor të shtetit.

Per sa me siper u arsyetua, gjykata çmon se kërkesa e kërkesve është pa objekt dhe si e tille e pa mbeshtetur ne ligj dhe në prova.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 190, 217, 218 dhe 379 të Kodit të Procedurës Penale

### VENDOSI

Rrëzimin e kërkesës së kerkuesve E.T. dhe E. N., si të pa bazuar ne ligj dhe në prova.

Shpenzimet proceduriale i ngarkohen kërkesve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall sot në Tiranë, më datë 02.07.2019.

SEKRETARE

GJYQTARE

ELENITA MYFTARI

VJOLLCA SPAHIU